

MBI PROGRAMET E KONTROLLIT PËR MBETJET E PESTICIDEVE¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të nenit 43, të pikës 7, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Programet e kontrollit për mbetjet e pesticideve të hartohen si pjesë e planit të kontrollit përkatës. Programi të përditësohet çdo vit.

2. Këto programe të bazohen në rrezik dhe të synojnë vlerësimin e ekspozimit të konsumatorëve në përputhje me nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në ushqim dhe ushqim për kafshët me origjinë bimore dhe shtazore. Në program duhet të specifikohet si më poshtë:

- a) produktet që do të kampionohen;
- b) numrin e mostrave që do të merren dhe analizat që do të kryhen;
- c) pesticidet që do të analizohen;
- ç) kriteret e aplikuara në hartimin e këtyre programeve, duke përfshirë:
 - i. kombinimet pesticide-produkt që do të zgjidhen;
 - ii. numrin e mostrave të marra për produktet vendëse dhe jovendëse përkatësisht;
 - iii. konsumi i produkteve si pjesë e dietës kombëtare;
 - iv. programin e kontrollit; dhe
 - v. rezultatet e programeve të mëparshme të kontrollit.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

¹ Ky udhëzim është përafruar pjesërisht me: rregullore e zbatimit të Komisionit (BE) 2021/1355, e datës 12 gusht 2021, “*Mbi programet kombëtare shumëvjeçare të kontrollit për mbetjet e pesticideve që do të vendosen nga shtetet anëtare*”.